

## RELACION

### PËR

### PROJEKTVENDIMIN

**“PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË HOLLËSISHME PËR USHTRIMIN E KOMPETENCAVE TË INSPEKTORATIT TË PËRGJITHSHËM, RREGULLAT PËR PËRMBAJTJEN, ADMINISTRIMIN E TË DHËNAVE TË SISTEMIT ELEKTRONIK “E-INSPEKTIMI”, MËNYRËN E RAPORTIMIT, KËRKIMIT TË INFORMACIONIT, INSPEKTIMIT TË DOSJEVE DHE DOKUMENTEVE TË NEVOJSHME, SI DHE MBIKËQYRJEN NË TERREN TË PROCEDURAVE TË INSPEKTIMIT”**

#### **I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Projektvendimi ka për qëllim përcaktimin e procedurave të hollësishme për ushtrimin e kompetencave të Inspektoratit të Përgjithshëm, si dhe vendosjen e rregullave për përmbajtjen, administrimin dhe përdorimin e të dhënave të sistemit elektronik unik të inspektimeve “e-Inspektimi”, në funksion të garantimit të një veprimtarie inspektuese të unifikuar, efektive dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Nëpërmjet këtij projektakti synohet krijimi i një kuadri të qartë dhe të standardizuar rregullator për organizimin dhe funksionimin e sistemit të inspektimit, duke siguruar përdorimin e detyrueshëm të sistemit “e-Inspektimi” nga të gjitha strukturat përgjegjëse për inspektimin, si dhe administrimin e integruar të të dhënave që lidhen me këtë veprimtari.

Objektivat kryesore që synohen të arrihen janë:

1. Përcaktimi i rregullave të detajuara për dokumentimin, administrimin dhe përpunimin e të dhënave të veprimtarisë inspektuese nëpërmjet sistemit elektronik “e-Inspektimi”, si bazë unike shtetërore;
2. Rritja e efektivitetit, cilësisë dhe transparencës së veprimtarisë inspektuese, përmes përdorimit të një sistemi të centralizuar dhe të automatizuar për programimin, autorizimin, ndjekjen dhe raportimin e inspektimeve;
3. Sigurimi i një qasjeje të bazuar në vlerësimin e riskut për planifikimin dhe zhvillimin e inspektimeve, me qëllim orientimin e burimeve drejt subjekteve dhe sektorëve me risk më të lartë;
4. Forcimi i rolit koordinues dhe mbikëqyrës të Inspektoratit të Përgjithshëm, nëpërmjet mekanizmave të monitorimit online dhe në terren të procedurave të inspektimit;
5. Garantimi i bashkërendimit institucional ndërmjet inspektorateve qendrore dhe vendore, si dhe shmangia e mbivendosjes së kompetencave dhe e dublimit të inspektimeve;

6. Përmirësimi i shkëmbimit dhe ndërveprimit të të dhënave me bazat e tjera shtetërore, në funksion të rritjes së eficiencës dhe cilësisë së vendimmarrjes;
7. Rritja e transparencës dhe llogaridhënies ndaj publikut, nëpërmjet raportimit periodik dhe publikimit të informacionit për veprimtarinë inspektuese;
8. Garantimi i sigurisë, integritetit dhe konfidencialitetit të të dhënave, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale;
9. Digjitalizimi i plotë i procedurave të inspektimit dhe reduktimi i proceseve manuale, me qëllim rritjen e eficiencës administrative dhe uljen e kostove.

Në tërësi, projektvendimi synon modernizimin dhe konsolidimin e sistemit të inspektimit në Republikën e Shqipërisë, duke e orientuar atë drejt një modeli të integruar, të bazuar në teknologji dhe në analizën e të dhënave, në funksion të garantimit të zbatimit të legjislacionit dhe mbrojtjes së interesit publik.

## **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Projektvendimi “Për përcaktimin e procedurave dhe rregullave të Inspektoratit të Përgjithshëm për administrimin e sistemit elektronik “e-inspektimi” dhe mbikëqyrjen online e në terren, programimin e inspektimeve, metodologjinë e vlerësimit të riskut, periudhën maksimale të inspektimeve vjetore si dhe raportimin” është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, për vitin 2026. Projektvendimi është hartuar në zbatim të përcaktimeve në ligjin nr. 99, datë 12.09.2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

## **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Hartimi i këtij projektvendimi vjen si domosdoshmëri për të plotësuar kuadrin nënligjor në zbatim të ligjit nr. 99, datë 12.09.2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe për të adresuar problematikat e evidentuara në praktikën e deritanishme të ushtrimit të veprimtarisë inspektuese dhe administrimit të sistemit elektronik “e-Inspektimi”.

Projektvendimi trajton disa problematika kyçe në sistemin aktual të inspektimit, duke përfshirë:

- a) Mungesa e një rregullimi të detajuar dhe të unifikuar për administrimin e të dhënave dhe funksionimin e sistemit “e-Inspektimi”, në përputhje me kuadrin e ri ligjor;
- b) Fragmentarizimi i informacionit dhe mungesa e ndërveprimit të plotë ndërmjet sistemeve të ndryshme shtetërore, duke ndikuar në cilësinë dhe efikasitetin e procesit të inspektimit;

---

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme për ushtrimin e kompetencave të inspektoratit të përgjithshëm, rregullat për përmbajtjen, administrimin e të dhënave të sistemit elektronik “e-inspektimi”, mënyrën e raportimit, kërkimit të informacionit, inspektimit të dosjeve dhe dokumenteve të nevojshme, si dhe mbikëqyrjen në terren të procedurave të inspektimit”

- c) Mbivendosja e kompetencave dhe mungesa e koordinimit efektiv ndërmjet inspektorateve qendrore dhe vendore;
- d) Përdorimi jo i standardizuar i metodologjive të vlerësimit të riskut në planifikimin dhe realizimin e inspektimeve;
- e) Kufizimet në mbikëqyrjen efektive të procedurave të inspektimit, si në nivel elektronik (online), ashtu edhe në terren;
- f) Niveli i pamjaftueshëm i transparencës dhe raportimit të veprimtarisë inspektuese.

Përparësitë e këtij projektvendimi përfshijnë:

- a) Vendos një kuadër të qartë dhe të detajuar rregullator për funksionimin e sistemit unik elektronik “e-Inspektimi” dhe për administrimin e të dhënave të inspektimit;
- b) Mundëson standardizimin dhe digjitalizimin e plotë të procedurave të inspektimit, duke reduktuar ndërhyrjet manuale dhe duke rritur efikasitetin administrativ;
- c) Forcon rolin koordinues dhe mbikëqyrës të Inspektoratit të Përgjithshëm, në përputhje me kompetencat e përcaktuara në ligjin nr. 99/2024;
- d) Siguron një qasje të bazuar në risk për planifikimin dhe zhvillimin e inspektimeve, duke optimizuar përdorimin e burimeve;
- e) Përmirëson bashkërendimin ndërinstitucional dhe shmang mbivendosjen e kompetencave ndërmjet strukturave inspektuese;
- f) Rrit transparencën dhe llogaridhënien përmes raportimit të automatizuar dhe publikimit të informacionit;
- g) Garanton një nivel më të lartë sigurie dhe konfidencialiteti të të dhënave, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Efektet e pritshme nga miratimi i projektaktit:**

- a) Rritja e eficiencës dhe efektivitetit të veprimtarisë inspektuese në nivel kombëtar;
- b) Përmirësimi i cilësisë së vendimmarrjes administrative, përmes përdorimit të të dhënave të integruara dhe analizës së riskut;
- c) Ulja e barrës administrative për subjektet e inspektimit, nëpërmjet procedurave të digjitalizuara dhe më të standardizuara;
- d) Rritja e besimit të publikut dhe biznesit ndaj institucioneve inspektuese, si rezultat i transparencës dhe parashikueshmërisë më të lartë;
- e) Forcimi i kontrollit mbi zbatimin e legjislacionit dhe parandalimi më efektiv i shkeljeve;
- f) Konsolidimi i një sistemi modern të inspektimit, të mbështetur në teknologji dhe në menaxhimin e integruar të të dhënave.

Në tërësi, projektvendimi paraqet një ndërhyrje të domosdoshme rregullatore, e cila synon adresimin e mangësive ekzistuese dhe përmirësimin e ndjeshëm të funksionimit të sistemit të inspektimit, në përputhje me standardet bashkëkohore të administratës publike dhe kërkesat e ligjit nr. 99/2024.

Akti i propozuar nuk ka për qëllim ndërmarrjen e proceseve të derregullimit dhe nuk sjell thjeshtim, reduktim apo eliminim të procedurave administrative ekzistuese.

Ky akt u gjenerua në sistemin e mbivendosjes ligjore dhe pas kërimit rezultoi se ky projektakt nuk ka mbivendosje ligjore.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektvendimi i propozuar mbështetet në nenin 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të pikës 6, të nenit 13, të ligjit nr. 99, datë 12.09.2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe të pikës 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.09.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE***

Projektvendimi nuk synon përafrimin me legjislacionin e Bashkimit Evropian (*acquis communautaire*).

#### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Projektvendimi është i strukturuar në 8 krerë, të cilët rregullojnë në mënyrë të detajuar organizimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë inspektuese, si dhe administrimin e sistemit elektronik “e-Inspektimi”, si më poshtë:

*Kreu I. QËLLIMI DHE FUSHA E ZBATIMIT*, i cili përcakton qëllimin e projektvendimit, që lidhet me rregullimin e procedurave për ushtrimin e kompetencave të Inspektoratit të Përgjithshëm dhe administrimin e sistemit “e-Inspektimi”, si dhe përcakton subjektet mbi të cilat shtrihet fusha e zbatimit, duke përfshirë inspektoratet qendrore, vendore dhe strukturat e tjera përgjegjëse për inspektimin.

*Kreu II. KOMPETENCAT E INSPEKTORATIT TË PËRGJITHSHËM PËR ADMINISTRIMIN E TË DHËNAVE TË SISTEMIT ELEKTRONIK “E-INSPEKTIMI”*, i cili parashikon kompetencat e Inspektoratit të Përgjithshëm në lidhje me administrimin e sistemit, përfshirë miratimin e rregullave, koordinimin dhe monitorimin e veprimtarisë inspektuese, mbajtjen dhe përditësimin e të dhënave, si dhe mbikëqyrjen e ligjshmërisë së procedurave të inspektimit.

*Kreu III. PËRMBAJTJA, ADMINISTRIMI DHE FUNKSIONET E SISTEMIT UNIK ELEKTRONIK “E-INSPEKTIMI”*, i cili rregullon krijimin dhe funksionimin e sistemit si bazë unike shtetërore të të dhënave, përdorimin e tij të detyrueshëm nga strukturat inspektuese, zhvillimin

---

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme për ushtrimin e kompetencave të inspektoratit të përgjithshëm, rregullat për përmbytjen, administrimin e të dhënave të sistemit elektronik “e-inspektimi”, mënyrën e raportimit, kërkitim të informacionit, inspektimit të dosjeve dhe dokumenteve të nevojshme, si dhe mbikëqyrjen në terren të procedurave të inspektimit”

e procedurave administrative të inspektimit në mënyrë elektronike, si dhe funksionet kryesore të sistemit në mbështetje të veprimtarisë inspektuese.

*Kreu IV. TË DHËNAT PARËSORE, DYTËSORE, AKSESIMI DHE NDËRVEPRIMI ME BAZAT E TJERA*, i cili përcaktohen kategoritë e të dhënave që administrohen në sistemin “e-Inspektimi”, nivelet e aksesit për përdoruesit, si dhe ndërveprimi me bazat e tjera shtetërore të të dhënave, me qëllim sigurimin e një sistemi të integruar informacioni.

*Kreu V. INFORMIMI DHE RIPRODHIMI I PËRMBAJTJES SË SISTEMIT (SIGURIMI I BAZËS SË TË DHËNAVE)*, i cili parashikon rregullat për përdorimin, publikimin, riprodhimin dhe aksesin në të dhënat e sistemit, duke garantuar transparencën dhe njëkohësisht mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin e informacionit.

*Kreu VI. MBIKËQYRJA ONLINE DHE NË TERREN E VEPRIMTARISË INSPEKTUESE*, i cili rregullon mënyrën e ushtrimit të mbikëqyrjes nga Inspektorati i Përgjithshëm, si nëpërmjet sistemit elektronik, ashtu edhe në terren, duke përcaktuar procedurat, rastet dhe të drejtat për ndërhyrje në funksion të garantimit të ligjshmërisë dhe cilësisë së inspektimeve.

*Kreu VII. RAPORTIMI I VEPRIMTARISË INSPEKTUESE*, i cili përcakton detyrimet për raportim të Inspektoratit të Përgjithshëm dhe të inspektorateve, afatet dhe mënyrën e raportimit, si dhe përdorimin e sistemit “e-Inspektimi” për gjenerimin e raporteve periodike dhe vjetore.

*Kreu VIII. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT*, i cili përmban dispozitat për zbatimin e vendimit nga institucionet përkatëse, shfuqizimin e akteve të mëparshme që bien ndesh me këtë vendim, si dhe hyrjen në fuqi të tij.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Për zbatimin e projektvendimit ngarkohet për zbatim Inspektorati i Përgjithshëm, inspektoratet qendrore, vendore, si dhe strukturat e tjera inspektuese, në fushën e zbatimit të ligjit për inspektimin në Republikën e Shqipërisë.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTLIGJIT**

Projektakti është hartuar nga Inspektorati i Përgjithshëm, në konsultim paraprak me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit.

---

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme për ushtrimin e kompetencave të inspektoratit të përgjithshëm, rregullat për përmbajtjen, administrimin e të dhënave të sistemit elektronik “e-inspektimi”, mënyrën e raportimit, kërkimit të informacionit, inspektimit të dosjeve dhe dokumenteve të nevojshme, si dhe mbikëqyrjen në terren të procedurave të inspektimit”

Projektvendimi do të dërgohet për mendim pranë: Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë e Punëve të Brendshme, Ministrisë së Arsimit, Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Ministrisë së Mjedisit, Ministrisë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, Këshillit të Lartë Gjyqësor Këshilli Konsultativ Qeverisje Qendrore-Vendore Tirana, Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Departamentit të Administratës Publike dhe Qendrës së Botimeve Zyrtare.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Projektvendimi do shoqërohet me kosto financiare për buxhetin, e cila është për tu vlerësuar në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.

**PROPOZUESI**  
**MINISTRI I EKONOMISË DHE INOVACIONIT**  
**DELINA IBRAHIMAJ**

